



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**

*Shtojca 5a: Struktura e pjesës narrative të raportit vjetor për konsultimet e kryera publike të ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit.*

RAPORT GJYSMËVJETOR PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK PËR PERIUHDHËN  
JANAR – QERSHOR 2021  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

**1.Përmbledhja ekzekutive** (pasqyra e statistikave kryesore mbi konsultimet e kryera me mësimet e nxjerra, sfidat dhe mundësitë)

Gjatë periudhës Janar – Qershor 2021, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) ka përbushur në masën 100% detyrimin për konsultim publik të akteve të miratuara, objekt i Ligjit Nr. 146/2014 për “Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.

Konkretisht janë konsultuar nëpërmjet publikimit në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik dhe aktiviteteve të tjera konsultative, dy projektvendime të planifikuara në Planin Vjetor të Konsultimit Publik 2021:

1. Vendimin Nr. 276, datë 12.5.2021 “Për miratimin e planit kombëtar për personat me aftësi të kufizuara, 2021–2025”.
2. Projektvendim “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 - 2030”.

Vlerësohet se procesi, në raport me periudhën e kaluar (vitin 2020), ku pjesëmarrja e aktorëve ishte më e ulët është përmirësuar në të gjitha aspektet. Për herë të parë në RENJK janë dërguar komente nga publiku lidhur me konsultimin publik të akteve, përpos komenteve të shumta të grumbulluara në takimet e zgjeruara konsultative. Takimet konsultative, ku pjesëmarrja e aktorëve të interesit ka qënë maksimale janë zhvilluar kryesisht online, nëpërmjet platformave Zoom dhe Webex, për shkak të situatës së COVID-19 dhe në respekt të masave kufizuese lidhur me organizimet dhe grumbullimet.

Gjithashtu, element pozitiv për periudhën aktuale në raport me vitin e kaluar, është numri më i lartë i akteve të planifikuara për konsultim publik. 35% e akteve do të nënshtrohen konsultimit publik përkundrejt 28% të akteve për vitin 2020.

Sfidat mbeten në rrafshin e përfshirjes së aktorëve joqeveritarë. Ndonëse ka patur përmirësime (sikurse trajtohet me gjerë në vijim), mund të bëhen akoma më shumë përmirësime. Përdorimi i takimeve konsultative të tipit Hibrid (online dhe takime ballë për ballë) mendojmë që janë forma efektive të konsultimit pasi avantazhojnë pjesëmarrje të plotë të aktorëve duke shpenzuar më pak nga koha e tyre.

**2.Analiza e konsultimeve të kryera**

***2.1.Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike***

***2.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një (gjysmë)vit të caktuar?***

Për periudhën Janar – Qershor 2021 janë miratuar 38 akte.

Nga këto, 5 akte kanë qenë të planifikuara në Programin e përgjithshëm analitik të akteve, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 1121, datë 30.12.2020 “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2021” dhe 34 janë miratuar jashtë këtij Programi.

2 akte nga Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve i janë nënshtruar konsultimit Publik.




#### 2.1.2. Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

Janë konsultuar dy akte, konkretisht: Vendimi Nr. 276, datë 12.5.2021 “Për miratimin e planit kombëtar për personat me aftësi të kufizuara, 2021–2025” dhe Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 - 2030”, të cilët janë Vendime me rëndësi strategjike dhe sipas pikës 1, të Nenit 1 të ligjit “Për konsultimin Publik”, i nënshtrohet këtij procesi.

Ndërkohë aktet e tjera të miratuara ndahen si më poshtë:

1. 14 Akte Normative, të cilat sipas shkronjës “ç”, të Nenit 4, të Ligjit “Për konsultimin publik”, nuk i nënshtrohen këtij procesi.
2. 19 Vendime të Këshillit të Ministrave, të cilat ndahen në kategoritë e mëposhtme:
  - a) 5 Marrëveshje ndërkombëtare, të cilat sipas shkronjës “b”, të Nenit 4, të Ligjit “Për konsultimin publik”, nuk i nënshtrohen këtij procesi;
  - b) 14 akte administrative me karakter normativ, të cilat sipas shkronjës “c”, të Nenit 4, të Ligjit “Për konsultimin publik”, nuk i nënshtrohen këtij procesi.



**2.1.3. Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?**

Për këtë periudhë nuk janë konsultuar akte të cilat shoqërohen me VNR. Aktet e planifikuara për konsultim janë në katërmujorin e tretë të programit të përgjithshëm analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2021”.

**2.1.4. Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përfundimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?**

Në PPAP janë përjashtuar (me anë të kriterëve përjashtuese) 16 akte. (Sqarojmë se këto akte kanë qenë Akte Normative dhe Vendime të Këshillit të Ministrave, të cilat nuk kanë qenë dokumente strategjike). Nga PKIE dhe dokumentet strategjike nuk ka akte për të cilat janë aplikuar kriteret përjashtuese. Janë parashikuar një projektligj për tremujorin e katërt dhe dy Vendime (Vendimi Nr. 276, datë 12.5.2021 “Për miratimin e planit kombëtar për personat me aftësi të kufizuara, 2021–2025” dhe Projektvendim “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 - 2030”)

**2.1.5. Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?**

Janë konsultuar 2 (dy) projektvendime me rëndësi strategjike.

**2.1.6. A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?**

Situata në krahasim me vitin e kaluar është përmirësuar.

Për periudhën Janar – Qershor 2021 janë përfshirë një numër i gjerë aktoresh, në disa platforma si RENjK, email, Zoom dhe sugjerimet e tyre janë reflektuar si në raportin individual të konsultimit ashtu edhe në relacionin e dërguar në Këshillin e Ministrave duke pasqyruar nëse janë pranuar ose dhe pse. Në krahasim me vitin 2020, ku procesi i konsultimit publik u krye por kishte disa mangësi në hartimin e raportit individual sipas formatit të

miratuar (pavarësisht se komentet e marra dhe sqarimet mbi reflektimin ose jo të tyre janë dhënë në relacionin dërguar Këshillit të Ministrave) për vitin 2021, hapat e procesit janë respektuar rigorozisht: Projektvendimet janë publikuar në sistemin e informacionit të qeverisë (RENJKP), është dhënë informacion i mjaftueshëm lidhur me konsultimin e gjerë me grupet e interesit dhe janë ruajtur prova të mjaftueshme për reagimet e tyre nëpërmjet raporteve individuale, në draftin e ri pasqyrohet një shkallë e mirë e reflektimit të reagimit të palëve të interesuara.

## **2.2. Metodat e konsultimit**

2.2.1. *Cilat ishin metodat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)*

### **A) Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 - 2030”:**

1. Takime me grupet e interesit; Për shkak të respektimit të masave lidhur me situatën e COVID-19, takimet janë zhvilluar **online**. Grupet e interesit nënkupton: institucionet shtetërore dhe jo-shtetërore në nivel qendror dhe të vetëqeverisjes vendore, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, institucionet e pavarura, akademinë dhe organizatat e shoqërisë civile të specializuara për trajtimin e çështjeve të barazisë gjinore, dhunë me bazë gjinore e dhunës në familje.
2. Mbledhja e mendimeve dhe sugjerimeve, të dërguara nëpërmjet postës elektronike nga të interesuarat/interesuarit, në postën elektronike zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Këto mendime janë përcjellë pas takimeve online, si dhe në periudha ndërmjet përmirësimit të drafteve të dokumentit nga ana e Grupit Ndërinstitucional të Punës. Korrespondenca është mbajtur nëpërmjet adresave zyrtare të stafit të Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (kryesisht nëpërmjet adresave të Sektorit të Politikave dhe Strategjive të Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore).
3. Takime konsultuese me:
  - a) Grupin Tematik Ndërinstitucional të Përfshirjes dhe Mbrojtjes Sociale, datë 15.04.2021;
  - b) Mbledhja e Këshillit Konsultativ Qeveri Qendrore – Vetëqeverisje Vendore, datë 20.05.2021.
4. Draft-SKBGJ është publikuar për konsultim publik në datën 23 mars 2021 në adresën: **<https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/347>**

### **B) Vendimi Nr. 276, datë 12.5.2021 “Për miratimin e planit kombëtar për personat me aftësi të kufizuara, 2021–2025”:**

1. Pikat fokale në cdo institucion,
2. Organizatat e/ për Personat me aftësi të Kufizuar. (ëeb),

3. Grupi tematik për Punësimin dhe Mbrojtjen Sociale, (online),
4. Nëngrupi Temarik për Përfshirjen dhe Mbrojtjen Sociale(online),
5. Këshilli Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara,(online),
6. Janë kryer takime individuale me drejtoritë e buxhetit për të konsultuar masat e Planit
7. Publikuar në <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/333>

2.2.2. *Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?*

**A) Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 - 2030”:**

Takimet online me grupet e interesit ku gjithsej *të angazhuar aktivisht* me dhënie komentesh në takimet parapërgatitore dhe ato konsultuese, si dhe me shkrim, rezultojnë **37 institucione qendrore dhe vendore, institucione të pavarura dhe organizata të shoqërisë civile.**

**B) Vendimi Nr. 276, datë 12.5.2021 “Për miratimin e planit kombëtar për personat me aftësi të kufizuara, 2021–2025”**

Konsultimi me e-mail ishte më eficient. Komentet në diskutimet në takime gjithashtu ishin të rëndësishme për përmirësimin e draft-VKM .

2.2.3. *A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?*

**A) Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 - 2030”:** *Të ftuar* në takimet parapërgatitore dhe konsultuese ishin **151 institucione qendrore dhe vendore, institucione të pavarura dhe organizata të shoqërisë civile.** 15 ministritë anëtare të GNP-së, INSTAT, AP, KMD, PSHSH, 61 NJVV, 70 organizata të shoqërisë civile, si dhe Departamenti për Zhvillim dhe Mirëqeverisje pranë Kryeministrisë.

**B) Vendimi Nr. 276, datë 12.5.2021 “Për miratimin e planit kombëtar për personat me aftësi të kufizuara, 2021–2025”:** Po, zhvilloi pesë takime konsultimi.

**B) Vendimi Nr. 276, datë 12.5.2021 “Për miratimin e planit kombëtar për personat me aftësi të kufizuara, 2021–2025”:** Po, zhvilloi pesë takime konsultimi.

**2.3. Kohëzgjatja e konsultimeve**

**A) Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 - 2030”:** 13 Nëntor 2020 – 20 Maj 2021

**B) Vendimi Nr. 276, datë 12.5.2021 “Për miratimin e planit kombëtar për personat me aftësi të kufizuara, 2021–2025”:** Konsultimet kanë zgjatur prej 1 Dhjetor 2020-30 Janar 2021

2.3.1. *Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?*

Të gjitha konsultimet janë kryer duke respektuar afatet të cilat fillojnë që nga momenti i njoftimit, kryerjes së takimeve dhe afatit të lënë për marrjen e komenteve.

**A) Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 - 2030”:** Draft-SKBGJ është publikuar për konsultim publik në datën 23 mars 2021 në adresën: <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/347>

**B) Vendimi Nr. 276, datë 12.5.2021 “Për miratimin e planit kombëtar për personat me aftësi të kufizuara, 2021–2025”:** Drafti i PVKM është publikuar për konsultim publik në datën: 05.03.2021, në faqen: <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/333>

2.3.2. *Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?*

**A) Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 - 2030”:** Midis 20-25 ditëve

**B) Vendimi Nr. 276, datë 12.5.2021 “Për miratimin e planit kombëtar për personat me aftësi të kufizuara, 2021–2025”**, ndërmjet 20-25 ditëve.

2.3.3. *A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?*

Po, në të dyja rastet takimet online kanë lejuar pjesëmarrjen e më shumë aktorëve në proces.

#### **2.4. Palët e interesuara të përfshira**

2.4.1 *Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?*

**A) Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 - 2030”:** Të angazhuara në mbështetje të gjithë punës së GNP-së ishin 4 eksperte për çështjet e barazisë gjinore, dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, statistikave gjinore e treguesve gjinorë, kostimit dhe buxhetimit të përgjigjshëm gjinor, të cilat u mundësuan përmes mbështetjes së UN Women.

**B) Vendimi Nr. 276, datë 12.5.2021 “Për miratimin e planit kombëtar për personat me aftësi të kufizuara, 2021–2025”:** Ekspertë të jashtëm që morën pjesë ishin 2.

2.4.2 *Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)*

**A) Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 - 2030”:** Institucionet e pavarura: Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjes nga Diskriminimi; si dhe Organizatat e Shoqërisë civile

**B) Vendimi Nr. 276, datë 12.5.2021 “Për miratimin e planit kombëtar për personat me aftësi të kufizuara, 2021–2025”:** OSHC, ekspertë individual.

2.4.3 Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultimet e hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?

**A) Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 - 2030”**

**Të pranishëm** në takimet parapërgatitore dhe konsultuese ishin **75 institucione qendrore dhe vendore, institucione të pavarura dhe organizata të shoqërisë civile**. 15 ministrinë anëtare të GNP-së, INSTAT, AP, KMD, PSHSH, 35 NJVV, 30 organizata të shoqërisë civile, si dhe Departamenti për Zhvillim dhe Mirëqeverisje pranë Kryeministrisë.


**Të ftuar** në takimet parapërgatitore dhe konsultuese ishin **151 institucione qendrore dhe vendore, institucione të pavarura dhe organizata të shoqërisë civile**.

Veçojmë si aktive: Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (për pjesën e punësimit), Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrin e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes.

Veçojmë si aktive bashkitë: Klos, Kukës, Pogradec, Tiranë.

Veçojmë si më aktive: AËEN, Qendra “Vatra” Vlorë, “Të Ndryshëm dhe të Barabartë” Tiranë (D&E), Qendra për Nisma Ligjore Qytetare Tiranë (CLCI), Qendra e Këshillimit për Gra dhe Vajza (QKGV) dhe Qendra e Këshillimit për Djem dhe Burra Tiranë (QKDB), Zyra për Djem dhe Burra Shkodër (ZBD), Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin Tiranë (ACPD), Qendra “Të drejtat e njeriut në demokraci” Tiranë (HRDC), Shoqata për Gratë, Paqen dhe Sigurinë Durrës, Qendra për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen” Tiranë, Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”(QAGJZH), Strehëza për Gratë dhe Vajzat Tiranë, Shoqata Kombëtare e Punonjësve Socialë, Forumi i Gruas Elbasan (FGE), Qendra Mary Ëard Loreto Shqipëri, Qendra për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri (CRCA), Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (ADRF).

**B) Vendimi Nr. 276, datë 12.5.2021 “Për miratimin e planit kombëtar për personat me aftësi të kufizuara, 2021–2025”:**



Në takimet konsultative morën pjesë dhe dhanë komente organizatat e mëposhtme:

1. “Shoqata e Invalidëve me dëmtime në shtyllën kurrizore”;
2. “Doën Syndrome Albania”
3. “Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë
4. Caritas Albania
5. MEDPAK

2.4.4 *Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?*

**A) Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 - 2030”**

*Të pranishëm* në takimet parapërgatitore: 30 OJF

*Të ftuar* në takimet parapërgatitore dhe konsultuese: 70 OJF

**B) Vendimi Nr. 276, datë 12.5.2021 “Për miratimin e planit kombëtar për personat me aftësi të kufizuara, 2021–2025”:**

Shoqatat mund të ndahen në shoqata me anëtarësi dhe shoqata që punojnë në fushën e aftësisë së kufizuar. Po ashtu ka 7 OSHC që janë pjesë e Këshillit Kombëtar të Aftësisë së kufizuar dhe kanë status anëtarë të Këshillit.

2.4.5 *A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?*

Po, janë përfshirë më shumë aktorë, sidomos anëtarë të organizatave të shoqërisë civile. Ndërkohë formatet për përgatitjen e akteve kanë kërkuar një punë më të specializuar prandaj janë përfshirë përveçse institucioneve shtetërore edhe ekspertë individual të fushës.

**2.5. Rekomandimet dhe komentet e marra**

2.5.1. *Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?*

**A) Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 - 2030”**

- 36 rekomandime dhe sugjerime të dhëna nga institucionet, OJF të , institucionet e pavarura dhe Alenaca e Grave Këshilltare
- 20 nga Organizatat Ndërkombëtare / donatorët

**B) Vendimi Nr. 276, datë 12.5.2021 “Për miratimin e planit kombëtar për personat me aftësi të kufizuara, 2021–2025”:**

- Numri i komente të marra është rreth 70.

2.5.2. *Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?*

**A) Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 - 2030”**

Janë pranuar rreth 80 % e sugjerimeve.



**B) Vendimi Nr. 276, datë 12.5.2021 “Për miratimin e planit kombëtar për personat me aftësi të kufizuara, 2021–2025”:** Komente të pranuar ishin 30 dhe komente të refuzuar ishin 10.

2.5.3. *Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?*

Po, janë përfshirë më shumë aktorë, sidomos anëtarë të organizatave të shoqërisë civile, kjo për arsye se dhe organizimi i mbledhjeve online e bën më të lehtë aksesin në çdo kohë dhe vend. Gjithashtu, është përdorur edhe RENjK për të dhënë komente të vlefshme, gjë që në vitet e tjera nuk ka ndodhur. Për SKGJB ka dhënë komente nëpërmjet RENjK Aleanca e Grave Këshilltare.

2.5.4. *Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?*

Për këtë periudhë nuk janë konsultuar akte të cilat shoqërohen me VNR. Aktet e planifikuara për konsultim janë në katëmuajorin e tretë të programit të përgjithshëm analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2021”.

Prandaj kjo pikë nuk aplikohet për gjashtëmuajorin e parë.

## 2.6. Raportet mbi rezultatet e konsultimit

2.6.1. *Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?*

Janë hartuar dy raporte konsultimi publik dhe janë publikuar në faqen zyrtare të Rregjistrimit Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike:

<https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/333>

<https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/347>

2.6.2. *Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?*

Raportet e hartuar janë publikuar dhe gjendet në faqen zyrtare të Rregjistrimit Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike:

<https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/333>

<https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/347>



**2.7. Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksin e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik** (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)

**A) Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 - 2030”:** 8

**B) Vendimi Nr. 276, datë 12.5.2021 “Për miratimin e planit kombëtar për personat me aftësi të kufizuara, 2021–2025”:** 8

Institucioni vlerëson se konsultimi i të dy dokumente ka qenë në nivel shumë të mirë. Në konsultimin e tyre janë përfshirë një numër i gjerë aktorësh. Dokumenti ka patur forume të ndryshme konsultimi, si RENjK, email, Zoom nëpërmjet tyre janë sjellë komente dhe feedback nga institucionet dhe shoqëria civile, ndërgjegjësimin për përfshirjen dhe aksesueshmërinë për PAK dhe rritjen e barazisë gjinore në fusha të ndryshme të aktivitetit shoqëror.

Sugjerimet e tyre janë reflektuar si në raportin individual të konsultimit ashtu edhe në relacionin e dërguar në Këshillin e Ministrave duke pasqyruar nëse janë pranuar ose jo dhe pse.

**3. Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen** *(Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)*

Sfidat mbeten përmirësimi i kapaciteteve të institucioneve dhe shoqërisë civile, duke u trajnuar për çështjet e legjislacionit të aksesueshmërisë sipas fushave dhe si rrjedhojë komentet dhe monitorimin e aktiviteteve të Planit; ndërtimi dhe forcimi i mekanizmave për zbatim kur janë më shumë se një aktor përgjegjës.

Takimet konsultative të tipit Hibrid (online dhe takime ballë për ballë) mendojmë që janë të vlefshme sepse kursejnë kohën e pjesëmarrësve dhe sigurojnë pjesëmarrje pothuaj të plote të të ftuarve.